



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 562/2 prot.

Tiranë, më 10.09.2020

VENDIM
Nr.89, datë 10.09.2020

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 218, DATË 27.12.2019,
NË INSTITUCIONIN BASHKIA DURREËS

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraparak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 218, datë 27.12.2019, të Komisionerit, *“Mbi paralajmërimin e institucionit Bashkia Durrës, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”*,

KONSTATOVA SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të nenit 65, germa “c”, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dispozitë e cila urdhëron përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për ata nëpunës të cilët kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, si dhe të detyrave të lëna në Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë *“Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2018”*, ku shprehimisht është kërkuar: *“Të shqyrtohen me prioritet rastet e individëve, pjesë e shërbimit civil në administratën qendrore dhe vendore, të cilët vazhdojnë marrëdhëniet e punës, megjithëse kanë arritur moshën e pensionit dhe duhet të kishin ndërprerë në kohë marrëdhëniet juridike dhe financiare”*, ka realizuar procesin e verifikimit lidhur me zbatimin e ligjit në këtë rast, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë.

Në këtë proces është përfshirë edhe institucioni i Bashkisë Durrës, i cili pas kërkesës së Komisionerit për informacion, nëpërmjet shkresës nr. 12738/1 prot., datë 13.07.2019, ka raportuar në lidhje me punonjësit që plotësojnë moshën e pensionit të plotë të pleqërisë deri në fund të vitit kalendarik.

Në këtë institucion punonjësit që plotësojnë këtë kusht, të evidentuar sipas pozicionit të punës dhe momentit të plotësimit të moshës për të përfutur pensionin e plotë të pleqërisë janë:

- ***** “*Inspektor*”, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 28.08.2019;
- ***** “*Specialiste*”, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 23.11.2019;
- ***** “*Specialist*”, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 17.11.2019.

Pas përfundimit të verifikimit, Komisioneri ka dërguar pranë Bashkisë Durrës, vendimin paralajmërues me nr. 218, datë 27.12.2019, “*Mbi paralajmërimin e institucionit Bashkia Durrës, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë*”, duke i lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës së konstatuar.

Në kuadër të procesit të mbikëqyrjes në vazhdim, Bashkia Durrës, me shkresat nr.387/1 prot., datë 16.01.2020 dhe nr.7168/1 prot., datë 13.07.2020, “*Kthim përgjigje*”, ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit të mbikëqyrur Bashkia Durrës, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim.

Konkretisht:

Ka përfunduar marrëdhënia e punës në shërbimin civil për shkak të ligjit, për punonjësit:

- ***** në pozicionin e punës “*Inspektor*”;
- ***** në pozicionin e punës “*Specialiste*”;
- ***** në pozicionin e punës “*Specialist*”.

Pozicionet respektive të punës, janë shpallur pozicione të lira, për t’u plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 218, datë 27.12.2019, *“Mbi paralajmërimin e institucionit Bashkia Durrës, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Bashkia Durrës.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha